



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË**

---

Numri i lëndës: 2020:158767  
Datë: 12.04.2024  
Numri i dokumentit: 05565912

**CP.nr.22/2022**

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil,** me gjyqtarin Genc Hasani, dhe me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Tahiri, në lëndën përmbartimore të kreditorit Q. H., te cilën e përfaqëson me autorizim avokat Festim Shala me seli ne Mitrovice, ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës – Drejtoria e Arsimit - Mitrovicë, lidhur me pagesën e borxhit ne baze te dokumentit përmbartimor - Aktgjykimi Cnr. 1317/2020, te datës 13.12.2021, të lejuar me aktvendimin për përmbartim CP 22/22, te datës 30.06.2022, jashtë seance gjyqësore, me datën 12.04.2024 morri këtë:

**A K T V E N D I M**

PËRFUNDOHET procedura përmbartimore e udhëhequr sipas shenjës CP 22/22, me kreditor Q. H., ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës – Drejtoria e Arsimit - Mitrovicë, për shkak të pagesës së tërësishme të borxhit nga debitori.

**A r s y e t i m**

Kreditorja e përmbartimit Q.H. te cilën e përfaqëson me autorizim avokat Festim Shala me seli ne Mitrovice, ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës – Drejtoria e Arsimit - Mitrovicë, ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të dokumentit përmbartimor - Aktgjykimi 1317/2020, te datës 13.12.2021.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të përmbartimit, me aktvendimin CP 22/22, te datës 30.06.2022, ka lejuar përmbartimin ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës – Drejtoria e Arsimit – Mitrovicë.

Pasi aktvendimi për ekzekutim CP 22/22, te datës 30.06.2022, është bere i ekzekutueshëm, kreditori nëpërmes përfaqësuesit me autorizim me dt. ..., ka njoftuar gjykatën se debitori i përmbartimit e ka përmbushur në tërësi borxhin.

Andaj, borxhi i kërkuar sipas propozimit për përmbartim është përmbushur në tërësi, pasi që debitori ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit të përmbartimit, gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 të LPP-së, në të cilin parashihet se “Pas përmbushjes se kredisë

*se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbartimore”, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**  
**CP.nr.22/2022 më datë 12.04.2024**

**Gj y q t a r i**

---

**Genc Hasani**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditorë nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Mitrovicë.